

Shqipëria

Gjatë vitit 2017, Shqipëria ka bërë një përparim të moderuar në përpjekjet për të eliminuar format më të rënda të punësimit të fëmijëve. Qeveria miratoi Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve në Punë, e cila parashtron një listë të profesioneve të rrezikshme për fëmijët nën moshën 18 vjeç. Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore ndërmori një fushatë ndërgjegjësimi. Krahas kësaj, qeveria e Shqipërisë ka miratuar Programin Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve, i cili synon të mbështesë zhvillimin dhe përfshirjen sociale të fëmijëve, krahas 101 fëmijëve që janë sistemuar në strehimore. Por pavarësisht nga këto masa, fëmijët në Shqipëri vazhdojnë të jenë të përfshirë në format më të rënda të punës, përfshi punën në miniera dhe lypjen e detyruar. Edhe pse qeveria ka bërë përpjekje domethënëse në të gjitha fushat relevante gjatë periudhës raportuese, ligji nuk e ndalon në mënyrë eksplicite përdorimin, mashtrimin ose ofrimin e fëmijëve për aktivitete të paligjshme. Krahas kësaj, Inspektorati i Punës duhet të forcohet për të kryer inspektimet e nevojshme në të gjithë sektorët e njohur ku shfrytëzohet puna e fëmijëve.

Bazuar tek raportimet, janë identifikuar sugjerimet për veprime që do të përparojnë më tej eliminimin e punës së fëmijëve, përfshi edhe format më të rënda të saj, në Shqipëri.

Fusha	Sugjerime për veprim	Viti(et) e sugjeruara
Kuadri ligjor	Të garantohet që shfrytëzimi, mashtrimi dhe ofrimi i fëmijëve nën 18 vjeç për aktivitete të paligjshme, përfshi edhe në prodhimin dhe trafikimin e drogës, të dënohet penalisht.	2015 – 2017
Zbatimi	Të pajisen Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve me staf dhe fonde të mjaftueshme për të kryer punën në mënyrë efektive.	2013 – 2017
	Të sigurohet që Inspektorati i Punës të ketë një drejtor të përhershëm dhe që plani i Inspektoratit të Punës të jetë i përshtatshëm, duke synuar sektorët në të cilët është e njohur puna e fëmijëve.	2010 – 2017
	Të forcohet dhe promovohet mekanizmi i ankesave të punës në mënyrë që publiku i gjerë të raportojë rastet e punës së fëmijëve.	2017
	Inspektorati i Punës të pajiset me mjetet e nevojshme dhe të trajnohet në mënyrë që të mund të kryej inspektime.	2017
	Të sigurohet që hetuesit e punës dhe të policisë të marrin trajnim të shpeshtë rreth fëmijëve të angazhuar në format më të rënda të punës së fëmijëve.	2013 – 2017
	Të sigurohet që punonjësit e policisë kufitare të kontrollojnë siç duhet fëmijët e mitur, përfshi edhe emigrantët, dhe të zbatojnë siç duhet Procedurat Standarde të Veprimit për të identifikuar viktimat e trafikimit të fëmijëve.	2016 – 2017
Koordinim	Të sigurohet që të gjitha palët të marrin pjesë në takimet në vijim të Task Forcës Çështja e Mbyllur, përfshirë ZKKT (Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën Kundër Trafikimit të	2016 – 2017

Fusha	Sugjerime për veprim	Viti(et) e sugjeruara
	Qenieve Njerëzore), Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Policia e Shtetit.	
	Të forcohet koordinimi midis Inspektoratit Shtetëror të Punës, Shërbimeve Sociale Shtetërore dhe Policisë së Shtetit Shqiptar.	2016 – 2017
	Të garantohet që të emërohet Koordinatori i Anti-Trafikimit dhe që të trajtojë çështje që lidhen me shfrytëzimin seksual për fitim të fëmijëve.	2017
Programet Sociale	Të zhvillohen studime për të identifikuar më tej veprimtaritë e fëmijëve në bujqësi dhe ndërtim dhe për t'i informuar ata për politikat dhe programet.	2013 – 2017
	Të shtohen burimet, qasja në regjistrin civil, dhe shërbimet sociale të disponueshme për të miturit, përfshi fëmijët nga komunitetet Roma dhe Egjiptian, të përfshire në ose të rrezikuar të përfshihen në punën e fëmijëve.	2011 – 2017
	Të garantohet eliminimi i barrierave në arsim, si për shembull kostot penguese për pajisje shkollore dhe diskriminimi kundër fëmijëve Roma dhe Egjiptian.	2013 – 2017
	Të shtohet numri i strehimoreve për fëmijët që referohen nga oficerët e policisë.	2017
	Të miratohen programe për të ndihmuar fëmijët që shfrytëzohen në minierat e kromit.	2014 – 2017